

---

## Webinar: Përfshirja e përdoruesve të shërbimeve dhe kujdestarëve të tyre në kujdesin e shëndetit mendor dhe hulumtim

19 Prill, 2021

15:00 – 17:00 CET

Përfshirja e përdoruesve të shërbimeve në shëndetin mendor është pranuar të jetë 'gjë e mirë' megjithatë shpesh mbetet e paqartë se çfarë do të thotë dhe si mund të zbatohet në praktikë, veçanërisht në Evropën Jug-Lindore (EJL). Një përfshirje e tillë mund të ketë të bëjë me aspekte të ndryshme të trajtimit, pjesëmarrjen në avokim të komunitetit ose legjislacion dhe në projekte hulumtuese të shëndetit mendor. Në EJL, të tre segmentet janë ende në fillimet e tyre, sepse zhvillimi i tyre filloi në vitet 2000. Kohët e fundit, është bërë përparim i rëndësishëm në lidhje me përfshirjen e përdoruesve në hulumtime, e cila më parë ishte një fushë kryesisht e lënë pas dore. Projekti hulumtues i financuar nga Komisioni Evropian IMPULSE (2018-2021) synon të përmirësojë kujdesin për individët me çrregullime psikotike (<http://impulse.qmul.ac.uk/>). Brenda IMPULSE, pesë vende në EJL kanë krijuar me sukses Panelet Këshilluese të Përvojës së Jetuar (LEAP). LEAP-et kanë përfshirë individë me çrregullime psikotike, të cilët me kalimin e kohës zhvilluan një ekspertizë shumë unike në këshillimin e hulumtuesve të shëndetit mendor për të gjitha aspektet e procesit të hulumtimit. Kontributi i tyre ka përmirësuar cilësinë e hulumtimit dhe ka ndihmuar në interpretimin dhe shpërndarjen e gjetjeve të hulumtimit. Kjo ngjarje bashkoi përdoruesit e shërbimeve, kujdestarët, ekspertët dhe hulumtuesit të cilët ndanë punën e tyre dhe diskutuan përfshirjen e përdoruesve të shërbimeve në kujdesin dhe hulumtimin e shëndetit mendor.

Një video të regjistruar nga webinar-i mund ta gjeni këtu: <https://youtu.be/MO4Lm9pYi3o>

### Përmbledhje e mesazheve kryesore të webinarit

#### Temat kryesore të diskutuara:

- Destigmatizimi i çrregullimeve mendore
- Angazhimi me përdoruesit e shërbimeve në shërbimet dhe hulumtimet për shëndetin mendor

#### Objektivat e mësimit:

- Përmbledhje e llojeve të ndryshme të përfshirjes së përdoruesve të shërbimeve
- Bashkëprodhimi i shërbimeve të shëndetit mendor, avokimi, këshillimi i hulumtuesve
- Roli i organizatave të udhëhequra nga përdoruesit

**Panelisti i parë: Prof Norman Sartorius (Shoqata për përmirësimin e programeve të shëndetit mendor, Zvicër)**

Tema: Luftimi i stigmës, 2021

*Teksti në vazhdim është marrë nga një përmbledhje e një leksioni të ngjashëm për stigmën, shkruar dhe prezantuar nga Profesor Sartorius gjatë Kongresit Botëror të Psikiatrisë Sociale 2019*

(Sartorius N (2020) Fighting Stigma 2020: Synopsis of the Presentation of the Yves Pelicier Prize Lecture at the World Congress of Social Psychiatry, Bucharest, October 2019. World Social Psychiatry, Vol. 2, Issue 3, September-December 2020.)

Stigma është akoma e lidhur me sëmundjet mendore dhe me gjithçka që e prek atë. Lajmi i mirë është se pas programit "WPA Global Open Doors" kundër stigmës, në vitet e fundit është parë zhvillimi i programeve kombëtare dhe rajonale që synojnë të ulin stigmën në shumë vende. Përvoja e fituar në këto programe çoi në riformulimin e paradigmave që rregullojnë mënyrat e qasjes së luftës kundër stigmës - një zhvillim me rëndësi të madhe për shkak të gjasave që stigma e çrregullimeve mendore të bëhet edhe më e dëmshme në të ardhmen, për një larmi arsyesh .

Në përmbledhje, paradigmat e reja të punës kundër stigmës propozojnë që programet kundër stigmës duhet të drejtohen te grupe njerëzish të përcaktuara mirë dhe se atyre duhet t'u paraprijë një eksplorim i pikëpamjeve dhe situatave të tyre në të cilat ata do të takojnë njerëz me çrregullime mendore. Puna kundër stigmës nuk duhet të kryhet nga fushata por të bëhet pjesë rutinë e programit të shërbimeve shëndetësore, të planifikuara, të përhershme dhe të financuara si çdo funksion tjetër jetësor i shërbimit. Në programet anti-stigmatizuese, përpjekjet për të rritur njohuritë e shëndetit mendor duhet të ndjekin përvetësimin e aftësive praktike duke u mundësuar njerëzve të kuptojnë dhe të punojnë me njerëzit që vuajnë nga çrregullime mendore. Qëllimi i programeve anti-stigmatizuese duhet të jetë një ndryshim i sjelljes në lidhje me njerëzit me çrregullime mendore, jo vetëm një deklaratë e qëndrimeve të ndryshuara. Vlerësimi i suksesit të programeve anti-stigmatizuese duhet të kërkohet në përmirësimet e ligjeve në lidhje me çrregullimet mendore, në normat e punësimit të njerëzve me çrregullime mendore, në pranimin e tyre në komunitet, në strehim dhe mundësitë për pjesëmarrje në jetën e komunitetit. Qëllimi përfundimtar i programeve anti-stigmatizuese nuk duhet të jetë që komunitetet të tolerojnë ata që kanë çrregullime mendore, por që ata t'i përfshijnë ata dhe t'i trajtojnë ata siç do të bënte çdo anëtar tjetër i komunitetit.

Stigma për momentin mbetet pengesa kryesore për zhvillimin e shërbimeve të shëndetit mendor dhe për përmirësimin e fatit të njerëzve që përfshijnë çrregullime mendore. Është e rëndësishme të luftosh kundër stigmës dhe të përdorësh të gjitha mjetet e mundshme për ta parandaluar atë ose për të zvogëluar pasojat e saj.

**Panelistët e dytë dhe të tretë: Tihana Majstorovic (OJQ Menssana, Bosnia and Herzegovina) & Dženana Nikšić (anëtare LEAP, Bosnia and Herzegovina)**

Tema: Terminologjia e përfshirjes së përdoruesve të shërbimeve dhe roli i tyre në shërbime dhe hulumtim

Format e përfshirjes së përdoruesve të shërbimeve:

- Ndihmë e drejtëpërdrejt për përdoruesit e tjerë
- Pjesëmarrja në proceset legjislative ligjore si pasojë e problemeve të shëndetit mendor
- Ekspertiza në projektet hulumtuese të lidhura me shëndetin mendor

Organizatave e drejtuara nga përdoruesit themelohen dhe drejtohen nga përdoruesit e shërbimeve. Qëllimet e tyre janë që përdoruesit e shëndetit mendor të marrin një rol më aktiv në krijimin e shërbimeve adekuate për të tjerët, të jenë pjesë e komunitetit lokal, të zvogëlojnë numrin e shtrimeve në spital dhe të përfshihen më shumë në jetën reale të komuniteteve të tyre.

Përmes përfshirjes së përdoruesve të shërbimit, përdoruesit kanë një mundësi për të ndihmuar të tjerët, për të zhvilluar role të reja dhe për të ndërtuar marrëdhënie të besueshme dhe të vlefshme me përdoruesit e tjerë. Pasja e përdoruesve të përfshirë në hulumtime dhe shërbime, ndihmon profesionistët të fitojnë një perspektivë krejtësisht të re të punës së tyre dhe për më tepër, kjo u mundëson atyre që ta mbajnë punën e tyre në kontakt me realitetin.

Mënyra që një organizatë e udhëhequr nga përdoruesit të bëhet e qëndrueshme është duke u njohur, e veqanërisht nga qeveria.

Përgjatë prezantimit është shfaqur një video për aktivitetet e MENNSANA. Video e shfaqur mund të gjendet në këtë ink: [https://youtu.be/F1c\\_VSRfjR8](https://youtu.be/F1c_VSRfjR8)

**Panelistët e katërt dhe pestë: Mina Aleksić (OJQ Prostor, Serbia) & Bosiljka Brdar (anëtare LEAP, Serbia)**

Tema: Prezantimi i udhëzuesit “Të punojmë së bashku”, që mbulon modelin e zhvillimit të suksesshëm të organizatave të përdoruesve

Udhëzuesi është një mjet i dobishëm për të udhëhequr zhvillimin e organizatave të reja të përdoruesve. Sipas një anëtari të grupit LEAP, përdoruesit e konsiderojnë atë të kuptueshëm dhe gjithëpërfshirës dhe situata në sistemin e shëndetit mendor është e prezantuar realisht. Mund t'u shërbejë përdoruesve si një burim informacioni i dobishëm, por gjithashtu si një nxitje për të marrë pjesë aktive në përmirësimin e vetë sistemit të shëndetit mendor, përmes përvajave dhe vëzhgimeve të tyre gjatë trajtimit të tyre, ndërsa klinikistët dhe profesionistët të tjerë të interesuar në zhvillimin e organizatave të ngjashme mund të mësojnë rreth shembujve të suksesshëm në rajon. Në mënyrë që ky proces të zhvillohet me sukses, është e rëndësishme të përcaktohen rolet e profesionistëve dhe përdoruesve në zhvillimin e një organizate përdoruesish.

Udhëzuesi është i disponueshëm në gjuhën Angleze, Serbe, Maqedone, Boshnjake dhe Malazeze këtu: <http://impulse.qmul.ac.uk/dissemination/lets-work-together-booklet/>

Përgjatë prezantimit është shfaqur një video mbi krijimin e organizatave të përdoruesve në Serbi. Kjo video mund të gjendet në linkun në vazhdim: <https://youtu.be/3Izhm5q1IKQ>